



Mihail Vasiljeviç Lomonosov


1711 – 1765

Mihail Vasiljeviç Lomonosov (Mikhail Vasiljevich Lomonosov) ishte një shkencëtar dhe poet i madh rus, i cili vendosi themelet e letërsisë dhe shkencës ruse; ai ishte artist, fizikan dhe historian. Si fizikan, Lomonosovi ishte një nga të parët që zhvilloi teorinë molekulare kinetike të nxehtësisë duke pohuar: **lëvizja korpuskulare (sot atomike) është e mjaftueshme për shpjegimin e nxehtësisë**. Ka dokumente që ai i parapriu ligjit të ruajtjes së masës. Sipas tij: **aq lëndë sa i shtohet një trupi i hiqet një trupi tjetër**. Ai, gjithashtu, zhvilloi teorinë valore të dritës.

Mihail Lomonosovi lindi në 8 nëntor të vitit 1711 në një fshat të quajtur Denisovka (sot Lomonosovo) pranë qytetit të Arhangelskut. Familja e tij ishte e mesme, me të ardhura të siguruar kryesisht nga peshkimi në det. Kur Mihaili ishte nëntë vjeç, i vdes e ëma dhe i ati martohet përsëri. E njerka ishte e pashpirt, e urrente djalin për dashurinë që kishte për librat.

Në moshën dhjetë vjeç shkoi me të atin në udhëtimet e gjata në Arktik dhe Nju-Lend. Që në atë kohë ai njihnte bizneset e rajoneve bregdetare: peshkimin, nxjerrjen e kripës nga uji i detit, mbledhjen e perlave dhe gjuetinë e fokave e lopëve të detit. Jeta me njerken në shtëpi u bë e padrueshme sa që Lomonosovi vendos të largohet nga shtëpia. Në fund të vitit 1730, pa thënë as mirupafshim (i ati nuk do ta linte të largohej), Lomonosovi i bashkohet një grupi slítash peshku që shkoi në Moskë.

Duke fshehur origjinën fshatare dhe duke deklaruar të ishte djali i një fisniku, mundi të futej në Akademinë Sllavo-Greko-Latine. Mbas pesë vjet varfërie Lomonosovi arrin të futet në dymbëdhjetëshen e më të mirëve që u dërguan për të vazhduar studimet në Akademinë e Shkencave të shën Petersburgut. Atje, në sajë të punës së palodhur dhe këmbënguljes, Lomonosovi ra menjëherë në sy. Nuk kaluan dy muaj dhe dërgohet në Gjermani për të studiuar në Universitetin e Marburgut.



Ai u martua me vajzën e një prodhuesi birre.

Ai mblodhi guaska perlash.



Lomonosovi zhvilloi teorinë kinetike të nxehtësisë.

Në Marburg martohet me vajzën e një prodhuesi gjerman birre me të cilën jeton i lumtur deri në fund të jetës. Qëndrimi në Gjermani sa nuk përfundon në tragjedi. Gjatësia dhe trupi i lidhur i tij i ranë në sy një oficeri gjerman që mblidhte rekrutë për ushtrinë e Frederik Vilhelmit. Përfshihet me mashtrim në lista dhe çohet në kështjellën e izoluar të Vezelit. Lomonosovi nuk mund ta duronte shërbimin ushtarak prusian ndaj kryen një arratisje të guximshme.

Në vitin 1741 Lomonosovi kthehet në Rusi. Kjo shënon fillimin e veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore në Akademinë e Shkencave të shën Petersburgut. Kur një grup shkencëtarësh u ngritën në protestë kundër disa rregullave në Akademi, Lomonosovi ishte në krye. **Incidenti u trajtua si shkelje serioze ndaj shkencëtarit i madh arrestohet**. Qëndroi 8 muaj në arrest, por vazhdon me vendosmëri kërkimet, derisa sëmuret rëndë dhe lirohet. Në vitin 1745 i jepet një katedër në shën Petersburg. Duke u bazuar në rezultatet e eksperimenteve në laboratorin e tij, ngre një fabrikë për prodhimin e mozaikëve perj qelqi të ngjyrosur.

Në vitin 1754 Lomonosovi paraqet projektidenë e universitetit të parë rus, sot Universiteti Shtetëror i Moskës. Veprimtaria shkencore, letrare dhe publike e Lomonosovit kanë zënë vendin që i takon në historinë e shkencës botërore. Emrin e tij e mbajnë një kreshtë mali nënujor në Oqeanin Arktik, një krater në anën e pasme të Hënës, një rrymë detare ekuatoriale në oqeanin Atlantik, një asteroid dhe një mineral.